



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 425, datë 8.7.2021

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT,
PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT
TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË ZONAT E REJA
TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 3.1, e vendimit nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3.1 Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2021, do të jetë në masën 1 331 932 076 (një miliard e treqind e tridhjetë e një milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

- a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 897 566 799 (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit

të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

- b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi prej 434 365 277 (katërqind e tridhjetë e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.”.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

A large, stylized handwritten signature in black ink, likely belonging to Erion Brace, is written over the printed name and extends across the right side of the page.A large, stylized handwritten signature in black ink, likely belonging to Arben Ahmetaj, is written over the printed name and extends upwards and to the left.